

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË “Internship” sh.p.k.

Sot më 18.08.2022, në Durrës, unë shtetasja e mëposhtëme:

Ekaterina Strati, lindur në Durrës, Shqipëri, në 20.10.1984, mbajtëse e letërnjoftimit Nr. 035509390, lëshuar nga Ministria e Brendshme në datën 31.12.2019 dhe e vlefshme deri në datën 30.12.2029, me Nr. Personal I46020068A, banuese në Durrës, Shqipëri,

bazuar në:

vullnetin tim të lirë;
Kushtetutën e Shqipërisë;

Kodin Civil;

Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare", i ndryshuar, kam vendosur që, nëpërmjet këtij Akti Themelimi, të themeloj shoqërinë "**Internship**" **sh.p.k.**

NENI 1

Shoqëria themelohet me emrin "**Internship**" **sh.p.k.**, emër i cili do të pasqyrohet edhe në vulën zyrtare të shoqërisë. Shoqëria "**Internship**" **sh.p.k.** mund të përdorë emrin "**Internship**" **sh.p.k.** ose emrin tregtar të shkurtuar **Internship**. Këtu e më poshtë në këtë Akt Themelimi, shoqëria "Internship" sh.p.k. do të referohet vetëm si shoqëria.

NENI 2

Selia e shoqërisë do të jetë në Bulevardi Dyrrah, Nr. 75, Durrës, Shqipëri.

NENI 3

3.1. Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Shqipërisë ose jashtë tij.

3.2. Me vendimarrjen e Asamblesë së Përgjithshme, shoqëria mund të themelojë degë ose zyra perfaqësimi, brenda ose jashtë territorit të Shqipërisë.

NENI 4

4.1. Kapitali themelues i shoqërisë është 1000 (një mijë) lekë, që përfaqësohet nga 1 (një) kuotë.

4.2. Pjesëmarrja e ortakut në Kapitalin themelues të shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij: Znj. Ekaterina Strati është pronare e vetme e kuotës në vlerën prej 1,000 (një mijë) lekë, të cilat përfaqësojnë 1 (një) kuotë të Kapitalit themelues me 100% të kapitalit të shoqërisë.

4.3. Kuotat janë nominale dhe nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë.

4.4. Çdo kuotë perfaqëson të drejtën për një votë.

NENI 5

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, në perputhje me objektin, për një periudhë kohore pa afat, që fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 6

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me objektin e përcaktuar në këtë Akt Themelimi, bazuar në legjislacionin shqiptar si dhe në Statutin bashkëlidhur këtij Akt Themelimi.

NENI 7

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë, përfshirë dhe pa u limituar:

- Zhvillimi i përkthimeve profesionale nga gjuhë të huaja (anglisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht, italisht etj.) në gjuhën shqipe dhe anasjellteas.
- Zhvillimi i kurseve të ndryshme të formimit profesional për gjuhë të huaja (anglisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht, italisht etj.).
- Funksionimi si qendër rregjistrimi për provimet ndërkombëtare të gjuhës angleze.
- Zhvillimi i kampeve verore për fëmijë.
- Funksionimi i qendrës në bazë të konceptit “after school”, duke ndërthurur studimin dhe argëtimin e fëmijëve pas orarit shkollor.
- Shoqëria ka si objekt veprimtarie kryerjen e të gjitha veprimtarive që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të ligjit shqiptar, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë si dhe çdo formë e aktiviteteve ligjore dhe komerciale që konsiderohet fitimprurëse për shoqerinë.

NENI 8

Shoqëria e fiton personalitetin e saj juridik dhe të drejtën për të ushtruar aktivitete si dhe për të marrë përsipër të drejta dhe detyrime, vetëm pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 9

Organi drejtues më i lartë i shoqërisë është **Asambleja e Përgjithshme**, e cila operon në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe merr vendime, përfshirë dhe pa u limituar, në përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë, amendimin e Statutit, emërimin dhe shkarkimin e administratorëve, likuidatorëve, Audituesve Ligjorë, mbikqyrjen e implementimit të politikave tregtare nga administratorët, themelimin e degëve të reja, miratimin e pasqyrave financiare dhe raportet e progresit të shoqërisë, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë si dhe çështje të tjera siç përcaktohen nga Statuti dhe legjislacioni përkatës.

NENI 10

10.1. Administratori emërohet nga Asambleja e Përgjithshme.

10.2. Ne aktin e emëritimit, përcaktohet edhe periudha e ushtrimit te funksionit, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

NENI 11

Administratori i shoqërisë është **Znj. Ekaterina Strati**, lindur në Durrës, Shqipëri, në 20.10.1984, mbajtëse e letërnjoftimit Nr. 035509390, lëshuar nga Ministria e Brendshme në datën 31.12.2019 dhe e vlefshme deri në datën 30.12.2029, me Nr. Personal I46020068A, banuese në Durrës, Shqipëri, i cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje.

NENI 12

Detajet në lidhje me menaxhimin e Kapitalit themelues, transferimin, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, menaxhimin administrativ të shoqërisë, balancat kontabël dhe financiare, falimentimin si dhe likuidimin etj., janë të përcaktuara qartësisht në Statutin e shoqërisë.

NENI 13

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 kopje në gjuhën shqipe me të njëjtën përbajtje dhe vlerë ligjore dhe, pasi u lexua, kuptua dhe u miratua ne parim dhe nen për nen nga ortaku themelues i shoqërisë "Internship" sh.p.k., nënshkruhet nga ai dhe hyn në fuqi me miratimin nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË "INTERNSHIP" sh.p.k.

MIRATIMI I KËTIJ AKT THEMELIMI NGA:

Ekaterina Strati

A handwritten signature in blue ink, reading "Ekaterina Strati". The signature is fluid and cursive, with "Ekaterina" on top and "Strati" below it, connected by a flourish. The name is written in a bold, rounded font.